

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



QEVERIA E KOSOVËS  
VLADA KOSOVA  
GOVERNMENT OF KOSOVA

*MINISTRIA E SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË*  
*MITMINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY*  
*MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEHNOLOGIJU*

# **MATURA SHTETËRORE 2014**

**7 dhe 21  
QERSHOR**

**29 Gusht  
6 Shtator**



## FJALA E MINISTRIT



Të dashur maturantë,

Provimi i Maturës Shtetërore, tashmë po ofrohet, përmes të cilit Ju do t'i tregoni aftësitë dhe shkathhtësitë, që i keni arritur gjatë gjithë niveleve të shkollimit. Provimi i Maturës Shtetërore do të jetë një sfidë dhe një moment i rëndësishëm në jetën Tuaj, sepse rezultatet që i arrini do t'iu mundësojnë që të vazhdoni shkollimin në arsimimin e lartë universitar.

Testit të Maturës Shtetërore do t'i nënshtroheni dy ditë: Në ditën e parë do të keni pyetje nga lëndët e përgjithshme (Gjuhë amtare, Gjuhë angleze dhe Matematikë), me ç'rast do të keni një test prej 120 pyetjeve.

Ndërkaq, ditën e dytë do të sprovoheni në pyetje nga lëndët më të afërta me profilin e shkollës, ku do të keni një test prej 80 pyetjeve, që do të thotë se i keni gjithsej 200 pyetje brenda një afati.

Provimi i Maturës është një instrument matës për të gjithë maturantët e Kosovës dhe, me këtë rast, pranë jush do të jenë mësimmësuesit, prindërit, përfaqësuesit e Drejtorive Komunale të Arsimit, MASHT-it dhe shoqëria në përgjithësi.

Sukses i Juaj është njëherit edhe sukses ynë, prandaj përgatitjet për një provim kaq të rëndësishëm dhe rezultatet e synuara do t'ju bëjnë që të ndiheni mirë dhe krenar gjatë gjithë jetës.

Në fund, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ju uroj sukses në Provimin e Maturës Shtetërore dhe në rrugën e mëtejme të dijës.

Suksese!

Prof. dr. Ramë Buja

Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

## PROCEDURAT E PROVIMIT

- Provimi i Maturës organizohet më 07 dhe 21 qershor 2014;
- Paraqitja e Provimit të Maturës bëhet më 14 - 27 maj 2014;
- Provimi mbahet në Qendrat e Testimit, të cilat i cakton DKA / MASHt;
- Lista me emrat e maturanëve dhe Qendrat e Testimit do të jetë në drejtorinë e shkollës së mesme të lartë që sapo e keni përfunduar;
- Të dy pjesët e Provimit të Maturës organizohen në datat e caktuara më lart dhe fillojnë në orën 10:00, ndërsa maturanët duhet të jenë në orën 8:30 te Qendrat e Testimit;
- Provim zgjat 180 minuta, pa e llogaritur kohën e shpërndarjes së testeve dhe kohën e udhëzimeve teknike, të cilat do t'i merrni nga administruesit e Testit. Pra, testimi fillon në orën 10:00 dhe përfundon në orën 13:30;
- Veproni sipas udhëzimeve të administruesit të Testit;
- Plotësoni me kujdes Broshurën e Testit e, sidomos Fletëpërgjigjen;

Pagesa për Provimin e Maturës Shtetërore është 5 € (pesë euro) dhe bëhet përmes Bankave, me Fletëpagesë që merret në drejtorinë e shkollës.

## KRITERET E PROVIMIT TË MATURËS

1. Provimi i Maturës Shtetërore organizohet në dy ditë. Në ditën e parë nxënësit do t'i nënshtrohen provimit nga lëndët e përgjithshme, ndërsa në të dytën, nga lëndët profesionale, sipas profileve përkatëse;
2. Të drejtën e Provimit të Maturës Shtetërore do ta kenë nxënësit që e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme të lartë, si dhe Provimin Përfundimtar, për arsimin profesional;
3. Kriteri i kalueshmërisë në provimin e maturës është 50% nga rezultati i përgjithshëm i testit, duke përfshirë atë të ditës së parë dhe të dytë;
4. Kandidati që e arrin kriterin e kalimit, 50% e më shumë, shpallet i diplomuar i shkollës së mesme të lartë, pajiset me **DIPLOMË** të maturës dhe fiton të drejtën e pjesëmarrjes në konkurrim për studime Universitare;
5. Maturanët e arsimit profesional, të cilët e kalojnë me sukses Provimin Përfundimtar, pajisen me Certifikatë, e cila u shërben për tregun e punës, ndërsa për studime universitare duhet t'i nënshtrohen Provimit të Maturës Shtetërore;
6. Maturanët që nuk mund ta arrijnë kriterin e kalimit, 50% në këtë afat, do të kenë të drejtë t'i nënshtrohen Provimit të Maturës në afatet vijuese;
7. Për pranim në Universitet Njësitë Akademike përcaktojnë kriteret e pranimit.

# Sqarimet më të hollësishme, maturanët do të marrin me rastin e shpalljes së konkursit për regjistrim në Universitet.

## MODELI I TESTIT

- Testi përmban kërkesa (pyetje) të tipit të mbyllur, me zgjidhje të shumëfishta, me katër alternativa, nga të cilat vetëm njëra është e saktë.

### Dita e parë:

- Për të gjithë maturantët, testi përmban 120 kërkesa (pyetje) nga lëndët e përgjithshme:

1. Gjuhë amtare	50 kërkesa
2. Gjuhë angleze	40 kërkesa
3. Matematikë	30 kërkesa

### Dita e dytë:

- Testi përmban 80 kërkesa (pyetje) nga lëndët e profilit përkatës arsimor.

#### I. Gjimnazi Matematikë - Informatikë

Dita e dytë: 80 kërkesa

1. Matematikë	30 kërkesa
2. Fizikë	15 kërkesa
3. Kimi	10 kërkesa
4. Biologji	10 kërkesa
5. Informatikë	15 kërkesa

#### II. Gjimnazi i Shkencave natyrore:

Dita e dytë: 80 kërkesa

1. Matematikë	10 kërkesa
2. Fizikë	20 kërkesa
3. Kimi	25 kërkesa
4. Biologji	25 kërkesa

#### III. Gjimnazi i Shkencave shoqërore

Dita e dytë: 80 kërkesa

1. Histori	25 kërkesa
2. Gjeografi	20 kërkesa
3. Sociologji	20 kërkesa
4. Psikologji	15 kërkesa

#### IV. Gjimnazi Gjuhësor

Dita e dytë: 80 kërkesa

1. Gjuhë shqipe	10 kërkesa
2. Gjuhë e dytë e huaj (Gjuhë gjermane ose Gjuhë frënge)	25 kërkesa
3. Histori	25 kërkesa
4. Sociologji	20 kërkesa

## MODELI I TESTIT

### V. Gjimnazi i Përgjithshëm

Dita e dytë: 80 kërkesa

- |                             |            |
|-----------------------------|------------|
| 1. Shkenca natyrore         | 50 kërkesa |
| (Kimi 25, Biologji 25)      |            |
| 2. Shkenca shoqërore        | 30 kërkesa |
| (Histori 15, Sociologji 15) |            |

### VI. Arsimi Profesional I.

(Shëndetësi, Bujqësi, Hortikulturë,  
Teknologji ushqimore, Kimi - teknologji, Gjeologji)

Dita e dytë: 80 kërkesa

- |                           |            |
|---------------------------|------------|
| 1. Kimi                   | 20 kërkesa |
| 2. Biologji               | 20 kërkesa |
| 3. Informatikë            | 20 kërkesa |
| 4. Ekonomi me ndërmarrësi | 20 kërkesa |

### VII. Arsimi Profesional II.

(Elektroteknikë, TIK, Komunikacion,  
Ndërtimtari, Arkitekturë, Gjeodezi, Tekstil, Xehetari)

Dita e dytë: 80 kërkesa

- |                           |            |
|---------------------------|------------|
| 1. Matematikë             | 20 kërkesa |
| 2. Fizikë                 | 10 kërkesa |
| 3. Informatikë            | 25 kërkesa |
| 4. Ekonomi me ndërmarrësi | 25 kërkesa |

### VIII. Arsimi Profesional III.

(Administratë, Ekonomi, Hoteleri, Turizëm,  
Shërbimi Postë - Telefoni)

Dita e dytë: 80 kërkesa

- |                           |            |
|---------------------------|------------|
| 1. Ed. qytetare           | 25 kërkesa |
| 2. Informatikë            | 20 kërkesa |
| 3. Ekonomi me ndërmarrësi | 25 kërkesa |
| 4. Gjeografi              | 10 kërkesa |

### XI. Arsimi Profesional IV. (Muzikë)

Dita e dytë:

- |                                      |            |
|--------------------------------------|------------|
| 1. Histori e muzikës dhe harmoni     | 25 kërkesa |
| 2. Intervalet dhe akordet            | 25 kërkesa |
| 3. Teori e muzikës, ritmet dhe masat | 30 kërkesa |

### X. Arsimi Profesional V. (Art dhe Grafikë)

Dita e dytë:

- |                    |            |
|--------------------|------------|
| 1. Histori e artit | 30 kërkesa |
| 2. Teori e formës  | 30 kërkesa |
| 3. Informatikë     | 20 kërkesa |

## DATA ME RËNDËSI:

### AFATI I QERSHORIT:

- Mësimi për maturantë përfundon më 14 maj 2014
  - Paraqitja e Provimit të Maturës Shtetërore më 14-24 maj 2014  
*Provimi i Maturës Shtetërore, Dita e parë, më 07 qershor 2014*  
*Provimi i Maturës Shtetërore, Dita e dytë, më 21 qershor 2014*
  - Publikimi i rezultateve, më 30 qershor 2014
  - Ankesat e nxënësve, më 30 qershor deri 4 korrik 2014
  - Publikimi i rezultateve të ankesave, më 07 korrik 2014 (përfundon afati i qershorit)
- # Paraqitja e provimit të maturës bëhet në drejtorinë e shkollës dhe evidentohet në fletore të posaçme, me numër protokolli, me dokumente të nevojshme dhe me dëshmi për pagesë.
- # Kandidatët që nuk e paraqesin me kohë Provimin e Maturës Shtetërore, konsiderohet se kanë hequr dorë nga provimi.
- # Kandidatët e kthyer nga bota e jashtme paraqiten në MASHT - DVSM, verifikojnë suksesin e pastaj caktohen se ku duhet t'i nënshtrohen Provimit të Maturës, më së largu deri më 30 maj 2014.

### AFATI I GUSHTIT:

- Paraqitja e Provimit të Maturës Shtetërore, më 14 - 23 gusht 2014
- Provimi i Maturës Shtetërore, Pjesa e parë, më: 29 gusht 2014
- Provimi i Maturës Shtetërore, Pjesa e dytë, më: 6 shtator 2014
- Publikimi i rezultateve, më 15 shtator 2014
- Ankesat e nxënësve, më 16-18 shtator 2014
- Publikimi i rezultateve të ankesave, më 19 shtator 2014 (përfundon afati i gushtit)

### ÇFARË NË DITËN E PROVIMIT?

Maturantëve u lejohej:

- Të jenë të pranishëm në Qendrën e Testimit, një orë e gjysmë para fillimit të testimit;
- Të kenë me vete letërnjoftimin;
- Të hyjnë brenda në kohën e caktuar, pas apellit të personit të autorizuar;
- Të ulen sipas udhëzimeve të administruesit / personit të autorizuar;
- Të kenë me vete një laps grafit, HB.
- Të kenë me vete një shishe me ujë të pijes;
- Të plotësojnë me kujdes të gjitha të dhënat në Fletëpërgjigje.

### NUK U LEJOHET TË :

- Vonohen në provim
- Kenë telefon celular apo ndonjë mjet tjetër për komunikim gjatë testimit;
- Ndërrojnë vendin pa lejen e administruesit.
- Kopjojnë në asnjë lloj forme;
- Pëshpërit apo të komunikojnë me të tjerët, në asnjë lloj forme;
- Dëmtojnë Fletëpërgjigjen, apo broshurën e testit;
- Pengojnë të tjerët gjatë kohës së testimit.

**MATURANTËT QË NUK U PËRMBAHEN KËTYRE RREGULLAVE,  
DO TË LARGOHEN NGA PROVIMI I MATURËS.**

## UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E FLETËPËRGJIGJES:

Të gjitha shënimet e kërkuara duhet të barten në fletëpërgjigje, si p.sh.

Në rubrikën KODI I IDENTIFIKIMIT duhet shënuar kodin e komunës, kodin e shkollës e kështu me radhë.

### MËNYRA E PLOTËSIMIT TË FLETËPËRGJIGJES:

KODI I IDENTIFIKIMI									
Komuna		Shkolla		Paralelja		Nr. i ditarit		Nr. i sallës	
0	4	1	2	0	3	2	0	0	8
<input checked="" type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input checked="" type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

Në Broshurën e testit janë kërkesat (pyetjet) me nga katër alternativa, prej të cilave vetëm njëra është e saktë. Përgjigjen që mendoni se është e saktë duhet rrethuar në test dhe të njëjtën duhet bartur në Fletëpërgjigje.

Shembull: Kërkesa e 24 e testit Është dhënë vargu i numrave: 1, 3, 7, 15, 31,... Cili është numri vijues në vargun e dhënë?

- A. 67
- B. 65
- C. 63
- D. 61

Alternativa C është e saktë. E rrethoni atë në test dhe të njëjtën e ngjyrosni me laps grafit në fletëpërgjigje, në këtë mënyrë:

24 (A) (B)  (C) (D)

Përndryshe, do të konsiderohet gabim nëse plotësohet në formë tjetër, si p.sh.:

24  (A) (B)  (C) (D)

24 (A) (B)  (C) (D)

Duhet pasur kujdes që, përgjigjen e saktë të një kërkesë të mos e vendosim mbi kërkesën tjetër. Duhet pasur kujdes që hijezimi i shënimeve të jetë i plotë.

## UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E FLETËPËRGJIGJES:

Plotësoni me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha të dhënat.

Lexoni me kujdes kërkesat -pyetjet e pastaj shënoni vetëm njërën nga katër përgjigjet që konsideroni se është e saktë.

Çdo pyetje e saktë vlerësohet me një pikë (1), ndërsa çdo pyetje e pasaktë vlerësohet me zero pikë (0).

Pyetja e paplotësuar, gjithashtu vlerësohet me zero pikë (0).


Fletëpërgjigjja plotësohet vetëm me laps grafit.

Kini kujdes gjatë mbushjes dhe bartjes së përgjigjeve nga broshura e testit në Fletëpërgjigje, sepse vetëm Fletëpërgjigjet lexohen, krahasuar me Broshurën e testit.

Përgjigjen e saktë e plotësoni në Broshurën e testit dhe, njëkohësisht e bartni në Fletëpërgjigje.

P.sh: Nëse në test, për pyetjen numër 1 keni konsideruar se alternativa C është e saktë, atëherë edhe në Fletëpërgjigje e plotësoni alternativën C.

Poashtu, nëse për pyetjen numër 2 konsideroni se përgjigja e saktë është alternativa B, edhe në Fletëpërgjigje e plotësoni alternativën B. Shih figurën:



Pikë negative nuk ka.

Llogaritjet apo ndonjë shënim tjetër mund t'i bëni në Broshurë të testit e assesi në Fletëpërgjigje.